

**RREGULLORE
E KËSHILLIT TË ARBITRAZHIT SPORTIV**

Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Komitetit Olimpik Shqiptar
më datë 31/5/2008

Hyrje

Me qëllim zgjidhjen e mosmarreveshjeve të lidhura me fushën e sportit, nëpërmjet arbitrazhit krijohet Këshilli i Arbitrazhit Sportiv i emërtuar shkurtimisht "KAS" i cili funksionon njëkohësisht si organ këshillimi pranë Komitetit Olimpik Shqiptar (shkurtimisht "KOKSH").

Këshilli i Arbitrazhit Sportiv është krijuar dhe funksion në bazë të:

- a) Kartës Olimpike, kreu V nenı 74;
- b) Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë;
- c) Ligjit nr. 9376, datë 21/04/2005 "Për sportin" kreu V, nenet 21 dhe 22;
- d) Statutit të KOKSH;
- e) Statuteve dhe Rregulloreve të anëtarëve të KOKSH;
- f) Statuteve dhe Rregulloreve të Organizmave Sportive Ndërkombëtare përgjithësisht të pranuara;

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Funksioni dhe Selia**

KAS është krijuar dhe funksion si organ këshillimi dhe arbitrazhi sportiv pranë Komitetit Olimpik Shqiptar. Ai e ushtron funksionin e tij për të zgjidhur mosmarrëveshjet në lidhje me sportin në ato raste kur kërkohet nga pala ose palët e interesuara apo kur një gjë e tillë është përcaktuar shprehimisht në një marrëveshje të veçantë midis palëve.

Selia e KAS është pranë Komitetit Olimpik Shqiptar në adresën: "*Muhamed Gjollesha*"
Sheshi Mustafa K. Ataturk, (ish 21 Dhjetori, Tiranë).

Neni 2
Misioni dhe Parimet

Misioni i KAS është zgjidhja e mosmarrëveshjeve në fushën e sportit nëpërmjet arbitrazhit si dhe dhënia e opinioneve dhe këshillave në lidhje me çdo çështje të së drejtës që rregullon sportin apo zhvillimin e sportit dhe çdo aktivitet tjeter të lidhur me sportin.

KAS synon të mbrojë të drejtat duke respektuar parimet e pavarësisë, konfidencialitetit dhe paanshmërise.

Neni 3
Arbitrat dhe Kriteret e Zgjedhjes

KOKSH përcakton një listë arbitrash te KAS, e cila rishikohët periodikisht dhe përbëhet nga 10 (dhjete) arbitra, të cilët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- a. Të ketë figurë e pastër morale
- b. Të zoterojë njohuri në të drejtën e sportit
- c. Të ketë dhënë kontribut konkret në fushën e sportit;
- d. Të jetë deri në moshën 70 vjeç.

Neni 4
Zgjedhja dhe Mandati i Arbitrave

Arbitrat e KAS zgjidhen nga KOKSH me propozim të:

- | | |
|--|----------------------|
| a. Presidenti i KOKSH | 1 person |
| b. Komiteti Ekzekutiv i KOKSH | 2 persona |
| c. Organizatat sportive anëtare të KOKSH | 1 deri në 10 persona |

Asambleja e Pergjithshme e KOKSH mbi bazën e propozimeve si më sipër, zgjedh arbitrat dhe harton listën përkatëse e cila është publike.

Arbitrat e KAS zgjidhen në detyrën e tyre për një afat 4 (katër) vjeçar me të drejte rizgjedhje.

Neni 5
Deklarata

Përpara fillimit të detyrës çdo arbiter i KAS nënshkruan një deklaratë me këtë përmnjatje:

“Unë i nënshkruari _____ si anëtar i KAS deklaroj me ndershmëri dhe përgjegjësi që do të zbatoj me besnikëri ligjin, do të përbush mirë dhe me besnikëri detyrat e mia si arbitër, do të ruaj sekretin e diskutimeve dhe të votimit si dhe do të veproj me objektivitet dhe pavaresi të plotë”.

Neni 6
Zëvendësimi

Nëse një arbitër i KAS vdes, jep dorëheqjen, ose për ndonjë arsyet tjetër nuk mund të ushtrojë detyrat e tij ai zëvendësohet për periudhën e mbetur deri në mbarim të mandatit në përputhje me procedurën e përcaktuar për zgjedhjen e tij sipas kësaj rregulloreje. Ne rast se është rasti i një procedure të filluar gjatë së cilës ndodh zëvendësimi, kjo porcedurë do te vazhdojë me rabitrine ri te zgjedhur pa bërë ripersëritje, me përjashtim të rastit kur palët ose trupa e arbitrazhit vendos ndryshe.

Neni 7
Shkarkimi

Arbitrat e KAS mund të shkarkohen nga KOKSH nëse refuzojnë të kryejnë detyrat sipas kësaj rregulloreje apo kur veprojnë në kundërshtim me të.

Kërkesa për shkarkimin e një arbitri të KAS e shoqëruar kjo me arsyet pse kërkohet, paraqitet për shqyrtim nga KOKSH nga subjekti që e ka propozuar shkarkimin. Kërkesa së bashku me arsyet i bëhen të ditura arbitrit të propozuar për shkarkim brenda 2 (dy) ditëve nga dita e marrjes së kërkesës.

Brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës për shkarkim, KOKSH fton ne mbledhje palët e interesuara, arbitrin e propozuar për shkarkim dhe arbitrat e tjera te KAS për të paraqitur ndonjë koment te tyren me shkrim dhe pasi shqyrton këto të fundit merr vendim në lidhje me sa është kërkuar.

KREU II

MOSMARREVESHJET ORGANIZIMI

Neni 8

Kategoritë e Mosmarrëveshjeve

KAS është kompetent për shqyrtimin në shkallë të parë të mosmarrëveshjeve sipas kategorive të poshtëshënuara:

a) Mosmarrëveshjet me karakter tregtar në lidhje me:

- Ekzekutimin e kontratave dhe akteve të tjera juridike;
- Sponsorizimin e aktiviteteve të ndryshme;
- Shitjen e të drejtës televizive;
- Organizimin e aktiviteteve sportive;
- Transferimin e lojtarëve;
- Kontratat e punës mes klubeve sportive dhe të punësuarve qofshin këta sportistë apo staf teknik;
- Mosmarrëveshjet midis sportistëve ose stafit teknik dhe klubeve sportive.

b) Mosmarrëveshjet për përgjegjësitë civile në lidhje me:

- Aksidentimin e një sportisti gjatë një aktiviteti sportiv.
- Dëmtimin e pronës së klubeve sportive si pasojë e veprimeve të dhunshme të kryera gjatë ose pas aktivitetit sportiv, por që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me këtë aktivitet.
- Dëmtimin e imazhit të klubeve sportive si pasojë e veprimeve apo deklarimeve të sportistëve apo stafit teknik.

KAS është kompetent për shqyrtimin në shkallë të dytë të mosmarrëveshjeve disiplinore të cilat janë gjykuar në shkallë të parë nga organet kompetente sportive për çështjet e mëposhtme:

- Mosmarrëveshjet midis federatave, shoqatave e organizatave sportive në përgjithesi për aq sa kjo nuk vjen në kundërshtim me statutet e këtyre organizatave ose është parashikuara në një marrëveshje të veçantë;
- Përdorimin e dopingut apo substancave të tjera të ndaluara të deklaruara si të tillë nga organizmat ndërkombëtare kompetente;

- Shkeljet disiplinore të kryera përgjatë aktiviteteve sportive (aktet e dhunës në terrenet sportive, fyerjes përkundrejt arbitrave në lojë, thirrjet fyeze dhe me karakter poshtëruar për klubet e tjera sportive etj.)

Neni 9 **Organizimi**

KAS organizohet si më poshtë:

- A. Kryetari i KAS;
- B. Seksioni i Gjykimit;
- C. Sekretaria.

A. KAS drejtohet nga Kryetari i cili zgjidhet nëpërmjet votimit të hapur, mes anëtarëve të tij me shumicë votash, duke përfshirë këtu edhe votën e kandidatit për Kryetar. Afati i qëndrimit në detyrë i Kryetarit është për një periudhë 4 (katër) vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje. Kryetari ushtron këto kompetenca:

- (i) Përfaqëson KAS në marrëdhënie me të tretë;
- (ii) Përgjigjet për mbarëvajtjen dhe mirëfunkcionimin e KAS;
- (iii) Percakton numrin e arbitrave dhe i cakton ata në rastet e përcaktuar në këtë rregullore;
- (iv) Kryen çdo detyrë tjeër të përcaktuar në këtë rregullore.

B. Seksioni i Gjykimit organizohet ne trupa te perbere nga 1 (një) ose 3 (tre) arbitra të caktuar sipas rregullave të kësaj rregulloreje për zgjidhjen e konflikteve të paraqitura për gjykim me procedurë arbitrazhi si shkallë e parë gjyktimi dhe për gjykimin me procedure arbitrazhi të apelimeve ndaj vendimeve të marra nga organizatat sportive.

C. Sekretaria e KAS funksion prane KOKSH dhe kryen detyrat e përcaktuara sipas kësaj rregulloreje.

KREU III
PROCEDURA E GJYKIMIT

A. GJYKIMI NË SHKALLË TË PARË

Sekzioni I
Rregulla te Pergjithshme

Neni 10
Përfaqësimi dhe Ndihma

Palët mund të përfaqësohen ose të ndihmohen nga persona të zgjedhur prej tyre. Emrat, adresat, numrat e telefonit dhe faksit të personave qe do të përfaqësojnë palët do t'i komunikohen, Sekretarisë, palës tjetër, dhe Trupit të Arbitrazhit menjeherë pas formimit të tij. Përfaqësim i palëve bëhet me prokurë.

Neni 11
Njoftimet dhe Komunikimet

Te gjitha komunikimet dhe njoftimet e KAS ose Trupit të Arbitrazhit drejtuar palëve do tju dërgohen nga Sekretaria. Te gjitha njoftimet do të bëhen me shkrim dhe u dërgohen palëve në adresat e shënuara në kërkesën për arbitrazh, kërkesën për apelim ose në kërkesën per opinion ose në çdo adresë tjetër të njoftuar në një datë të mëvonshme.

Të gjitha vendimet e arbitrazhit, urdhërat ose vendimet e tjera të marra nga KAS dhe Trupi i Arbitrazhit i njoftohen palëve me postë rekomande me lajmërim marrje.

Palët do t'i dërgojnë njoftimet e tyre drejtuar KAS ose Trupit të Arbitrazhit me postë rekomande me lajmërim marrje ose faks, në rast të kundërt ato konsiderohen të papranueshme. Kërkesa për arbitrazh, kërkesa për apelim, kërkesa për pjesmarrjen e palës së tretë, paraqitjet me shkrim dhe provat do të bëhen në aq kopje sa janë palët, arbitrat si dhe një kopje shtesë për vetë KAS.

Neni 12

Afatet

Afatet e caktuara në këtë rregullore do të fillojnë nga ditën që pason ditën në të cilën është marrë njoftimi nga KAS.

Ditët e pushimit javor dhe ditët e festave zyrtare përfshihen në llogaritjen e afateve. Afatet e caktuara në këtë rregullore do të konsiderohen se janë respektuar nëse komunikimi bëhet përpara orës 00:00 të ditës së fundit në të cilën mbaron afati. Nëse dita e fundit e mbarimt të afatit bie në ditët e pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare, afati do të mbarojë në ditën e punës që vjen pas saj.

Drejtuesi i Trupit të Arbitrazhit ose Kryetari i KAS, kur trupi i arbitrazhit nuk është formuar, me kërkesë të argumentuar, mund të vendosë zgjatjen e afateve të përcaktuara në këtë rregullore kur e kërkojnë rrethanat me përjashtim të afatit për paraqitjen e kërkesës për apelim.

Neni 13

Pavarësia e Arbitrit

Çdo arbitër është i pavarur nga palët dhe zbulon menjëherë çdo rrethanë e cila mund të ndikojë në pavarësinë e tij ndaj palëve.

Neni 14

Masat e Përkohëshme dhe Konservative

Asnjë nga palët nuk mund të paraqesë një kërkesë për masa të përkohshme ose konservative sipas kësaj rregullorje përpara se kërkesa për arbitrazh ose apelim të jetë paraqitur në KAS pasi të gjitha mjetet e tjera nuk kanë rezultuar të efektshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes mes palëve.

Kryetari i KAS përpara dërgimit të dosjes në Trupin e Arbitrazhit ose vetë Trupi i Arbitrazhit me kërkesën e njërsë palë mund të urdhërojë marrjen e masave të përkohshme ose konservative. Palët duke rënë dakort që t'ia nënshtrojnë këtyre rregullave proceduriale çdo mosmarrëveshje subjekt i procedurës së arbitrimit, shprehimisht heqin dorë nga e drejta për të kërkuar marrjen e këtyre masave nga organet shtetërore.

Nëse paraqitet një kërkesë për marrjen e masave provizore, Kryetari i KAS ose Trupi i Arbitrazhit fton kundërshtarin të shprehë opinionin e tij brenda 10 (dhjetë) ditëve ose për një afat më të shkurtër kur e kërkojnë rrëthanat. Kryetari i KAS ose Trupi i Arbitrazhit do të nxjerrin një urdhër brenda një kohë të shkurtër. Në raste urgjence, Kryetari i KAS përpara dërgimit të çëshjtes në Trupin e Arbitrazhit ose Drejtuesi i Trupit të Arbitrazhit mund të nxjerrin një urdhër menjëherë pas paraqitjes së kërkesës dhe dëgjimit të kundërshtarit.

Neni 15 **Kërkesa për Arbitrazh**

Kërkesa e paraqitur nga pala e interesuar për arbitrazh duhet të bëhet me shkrim dhe të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- emrin dhe adresën e palës paditëse dhe të palës së paditur;
- një përshkrim të shkurtër të fakteve dhe argumentave ligjorë duke përfshirë çështjet për të cilat kërkohet vendimi i KAS;
- kopje të kontratës që parashikon marrëveshjen e palëvë per të zgjidhur mosmarrëveshjet mes tyre nëpërmjet arbitrazhit ose çdo lloj dokumenti tjeter që parashikon zgjidhje nëpërmjet arbitrazhit;
- informacion mbi numrin dhe përcaktimin e arbitrave, sipas marrëveshjes dhe në veçanti nëse marrëveshja parashikon 3 (tre) arbitra, emrin dhe adresën e arbitrave të zgjedhur nga lista e arbitrave të KAS.

Me depozitimini e kërkeses, pala kryen pagesën a tarifës sipas përcaktiveve të KAS.

Në rast se kërkesa e paraqitur nuk është e plotë sipas kërkesave të mësipërme, Sekretaria i cakton palës një afat 10 (dhjetë) ditor për plotësimin e saj. Nëse pala e interesuar nuk plotëson kërkesën brenda afatit të caktuar, kërkesa konsiderohet se është térhequr.

Neni 16 **Fillimi i Arbitrazhit nga KAS**

Përveç rasteve kur, që në fillim është evidente se nuk ekziston një marrëveshje arbitrimi që i referohet KAS, në rastet e tjera Sekretaria do të ndërmarrë të gjitha

veprimet e nevojshme për të vënë në lëvizje gjykimin nëpërmjet arbitrazhit. Për këtë qëllim Sekretaria, në veçanti, do t'i komunikojë të paditurit kërkesën, të thërrasë palët që shprehen për ligjin e zbatueshëm në lidhje me mosmarrveshjen dhe t'i caktojë të paditurit afatet për të paraqitur çdo informacion që lidhet me numrin dhe caktimin e arbitrit/arbitrave dhe në veçanti për caktimin e një arbitri të KAS si dhe të paraqesë përgjigen për kërkesën për arbitrazh. Përgjigja duhet të përmbajë:

- a) një deklaratë të shkurtër mbrojtje;
- b) çdo mungesë juridikioni;
- c) çdo kundërkërkesë.

Neni 17 **Numri i Arbitrave**

Trupat e arbitrazhit përbëhen nga 1(një) ose 3(tre) arbitra. Nëse marrëveshja e arbitrazhit nuk përcakton numrin e arbitrave, Kryetari i KAS përcakton numrin e arbitrave duke marrë parasysh çështjet që janë në shqyrtim në momentin e paraqitjes së kërkesës si dhe kompleksitetin e çështjes.

Neni 18 **Caktimi i Arbitrave**

Nëse marrveshja e arbitrazhit ose në mungesë të saj vendimi i Kryetarit të KAS përcaktojnë gjykimin me trup arbitrazhi të përberë nga 1(një) arbitër, palët me marrëveshje mes tyre caktojnë arbitrin brenda 15(ditëve) nga njoftimi i Sekretarisë. Nëse palët nuk arrijnë të caktojnë një arbitër brenda afatit, Kryetari i KAS cakton arbitrin.

Nëse marrveshja e arbitrazhit ose në mungesë të saj vendimi i Kryetarit të KAS përcaktojnë gjykimin me një trup arbitrazhi të përbërë nga 3 (tre) arbitra, pala që paraqet ankesën cakton arbitrin në kërkesën për arbitrazh, ose brenda afatit të përcaktuar në vendimin për numrin e arbitrave, kurse pala tjetër cakton arbitrin e saj brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e marrë nga Sekretaria. Nëse palët nuk arrijnë të caktojnë arbitrat, Kryetari i KAS cakton arbitrat në vënd të palëve.

Drejtuesi i Trupit te Arbitrazhit zgjidhet me marrveshje mes dy arbitrave të caktuar nga palët brenda afatit të përcaktuar nga Sekretaria. Nëse dy arbitrat nuk arrijnë një

marrëveshje, Kryetari i KAS cakton Drejtuesin e Trupit të Arbitrazhit në vend të dy arbitrave.

Neni 19
Konfirmimi i Arbitrave dhe Transferimi i Dosjes

Çdo arbitër i zgjedhur nga palët konsiderohet i emëruar vetëm pasi konfirmohet si i tillë nga Kryetari i KAS.

Menjëherë pas krijimit të Trupit të Arbitrazhit, Sekretaria i dërgon dosjen e plotë të çështjes.

Neni 20
Arbitrazhi mes shumë palëve

Nëse kërkesa për arbitrazh paraqitet nga disa paditës dhe/ose i drejtohet disa të paditurve, Trupi i Arbitrazhit krijohet në përputhje me numrin e arbitrave dhe mënyrën e caktuar në marrëveshje mes palëve. Në mungesë të marrëveshjes Kryetari i KAS vndos për numrin e arbitrave në përputhje me nenin 17 të kësaj rregulloreje.

Në rastin e caktimit të një arbitri zbatohet nen 18. Nëse duhet të caktohen tre arbitra dhe ka më shumë se një paditës, paditësit me marrëveshje mes tyre caktojnë një arbitër. Nëse duhet të caktohen tre arbitra dhe ka më shumë se një të paditur, të paditurit me marrëveshje mes tyre caktojnë një arbitër. Në mungesë të arritjes së marrveshjes, Kryetari i KAS cakton arbitrat në vend të paditësave/të paditurve. Nëse ka tre ose më shumë palë me interesa të kundërtat, arbitrat do të zgjidhen me marrveshje mes palëve. Në mungesë të marrëveshjes Kryetari i KAS cakton arbitrat në përputhje me parashikimet e bëra në nenin 18. Në të gjitha rastet Drejtuesi i Trupit të Arbitrazhit zgjidhet nga vetë arbitrat në përputhje me nenin 18.

Neni 21
Bashkimi

Nëse pala e paditur kërkon pjesmarrjen e një pale të tretë në procedurën e arbitrazhit ajo duhet të përmendet në pergjigjen e të paditurit së bashku me arësyet e pjesmarrjes. Sekretari i komunikon personit që kërcohët të marrë pjesë një kopje të kérkesës dhe i

cakton një afat brenda të cilit duhet të deklarojë pozicionin e tij dhe të paraqesë përgjigen në përputhje me kërkesat e nenit 16.

Neni 22 **Pjesmarrja e Palës së tretë**

Pala e tretë që kërkon të marrë pjesë si palë në procedurën e arbitrazhit duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim ne KAS së bashku me arësyet dhe brenda afatit të përcaktuar per dhënien e përgjigjes nga i padituri ndaj kërkesës për arbitrazh. Kjo kërkesë për aq sa ështe e mundur do të ketë të njëjtën përbajtje si dhe kërkesa per arbitrazh.

Sekretaria i komunikon palëve një kopje të kësaj kërkesë dhe vendos afatin brenda te cilit ato mund të shprehin pozicionin e tyre lidhur me pjesmarrjen e palës së tretë dhe të paraqesin përgjigen e tyre sipas nenit 16.

Neni 23 **Pajtimi**

Kryetari i KAS, përpara transferimit të dosjes në Trupin e Arbitrazhit, dhe Trupi i Arbitrazhit pas transferimit të dosjes në çdo kohë mund të bëjnë përpjekje për zgjidhjen e çështjes me pajtim. Çdo zgjidhje e çështjes me pajtim mes pëlqimin e palëve materializohet në vendim.

Neni 24 **Konfidencialiteti**

Palët, arbitrat dhe KAS angazhohen të mos i zbulojnë palëve të treta fakte ose informacione që lidhen me konfliktet ose procedurat e shqyrtimit në KAS. Vendimet nuk behen publike. Ato mund të bëhen publike vetem nëse parashikohet në vendim ose palët bien dakord për bërjen publike të vendimit.

Sekzioni III **Procedura Përpara Trupit Të Arbitrazhit**

Neni 25 **Etapat e Procedurës**

Procedura përpara Trupi të Arbitrazhit përfshin:

- a) paraqitjen me shkrim të pretendimeve nga palët; dhe
- b) seancen degjimore nëse Trupi i Arbitrazhit e shikon të nevojshme

Drejtuesi i Trupi të Arbitrazhit kur e gjykon të nevojshme nxjerr udhëzime lidhur me paraqitjen me shkrim të pretendimeve nga palët.

Neni 26
Paraqitura e Pretendimeve te Palëve

Si rregull i përgjithshëm palëve u lejohet vetëm 1(një) paraqitje me shkrim e pretendimeve të tyre dhe në raste kur e kërkojnë rrethanat mund të paraqesin një kundërpërgjigje dhe një përgjigje të dytë.

Palët se bashku me pretendimet e tyre duhet të paraqesin të gjithë provat shkresore ku mbështesin pretendimet e tyre. Pas shkëmbimit të pretendimeve me shkrim palët nuk mund të paraqesin prova të tjera shkresore përvëç rasteve kur bihet dakord mes tyre ose kur Trupi i Arbitrazhit e lejon në rrethana të jashtëzakonshme.

Në paraqitjen e pretendimeve palët përcaktojnë çdo dëshmitar dhe ekspert që mendojnë të thërrasin si dhe çdo masë tjetër qe kërkohet prej tyre.

Neni 27
Seanca Dëgjimore

Pas përfundimit të shkëmbimit të pretendimeve të palëve, Drejtuesi i Trupit të Arbitrazhit përcakton udhëzime për zhvillimin e seances dëgjimore dhe cakton datën e zhvillimit të seancës dëgjimore. Data e zhvillimit të seancës dëgjimore i njoftohet palëve të paktën 7(shtatë) ditë përpara.

Gjatë seancës dëgjimore Trupi i Arbitrazhit dëgjon palët, dëshmitarët dhe ekspertët si dhe paraqitjen gojore të argumentave nga secila palë; i padituri ka të drejtën e fjalës i fundit.

Drejtuesi i Trupit të Arbitrazhit drejton seancen dëgjimore dhe siguron qe deklarimet e palëve të jenë koncize, të lidhen me pretendimet e paraqitura me shkrim dhe të kenë rëndesi pér çështjen. Seanca dëgjimore nuk është publike përveçse kur palët bien dakort ndryshe. Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore mbahet procesverbal.

Çdo person i thirrur pér tu degjuar nga Trupi i Arbitrazhit ka të drejtë të ndihmohet nga një përkthyes (kur është rasti i nje personi të huaj) me shpenzimet e palës që ka kërkuar thirrjen e tij.

Palët thërrasin pér tu degjuar nga Trupi i Arbitrazhit dëshmitarët dhe ekspertët e kerkuar në pretendimet e tyre me shkrim. Palët përgjigjen per gatishmerinë dhe mbulojnë shpenzimet e deshmitareve dhe ekspertëve të kërkuar pér tu dëgjuar. Me marrëveshje të palëve Drejtuesi i Trupit të Arbitrazhit, mund të përjashtojë një dëshmitar ose ekspert nga paraqitja në seancen degjimore nëse ky i fundit ka paraqitur një deklaratë me shkrim.

Trupi i Arbitrazhit mund të kufizojë ose mund të mos lejoje paraqitjen e një dëshmitari ose të ekspertit nëse gjykon se paraqitja e tyre nuk ka lidhje me çështjen.

Përpara se një dëshimtar, ekspert ose përkthyes të degjohet nga Trupi i Arbitrazhit ky i fundit fton deshmitarin, ekseprtin ose përkthyesin të deklarojnë solemnisht se do të thonë të vertetën.

Pas mbylljes së seancës dëgjimore, palët nuk mund të paraqesin pretendime të tjera me shkrim me përjashtim kur kërkohet nga Trupi i Arbitrazhit.

Trupi i Arbitrazhit, pas konsultimit me palët, mund të vendosë per mos zhvillimin e seancës dëgjimore kur ai e konsideron se është shume i informuar pér çështjen.

Neni 28

Veprime Proceduriale të Urdheruara nga Trupi i Arbitrazhit

Secila palë mund të kërkojë nga Trupi i Arbitrazhit që ky i fundit të urdhërojë palën tjetër të paraqesë dokumenta që janë në ruajte ose nën kontrollin e kesaj të fundit. Pala që kërkon një gjë të tillë duhet të vërtetojë se këto dokumenta ekzistojnë dhe janë të rendësishme pér çështjen.

Nëse Trupi i Arbitrazhit e shikon të nevojshme plotësimin e paraqitjes së pretendimeve të palëve, ai mund të kërkojë në çdo kohë paraqitjen e dokumentave shtesë ose shqyrtimin e dëshmive, caktimin dhe degjinin e ekspertëve si dhe të kryejë veprime të tjera proceduriale. Trupi i Arbitrazhit mund t'i urdhërojë palët të mbulojnë shpenzimet shtesë që lidhen me dëgimin e deshmitarëve ose ekpertëve.

Trupi i Arbitrazhit konsultohet me palët ne lidhje me caktimin e ekspertit dhe termat e references. Ekerti i caktuar nga Trupi i Arbitrazhit do te jete i pavarur nga palët dhe do te zbulojë çdo rrethana e cila mund të ndikojë në pavarësine e tij ndaj palëve.

Neni 29
Procedura e Përshpejtuar

Trupi i Arbitrazhit me pëlqimin e palëve mund të procedojë me procedure te përshpejtuar duke nxjerre udhëzime për zhvillimin e saj.

Neni 30
Mosparaqitja

Nëse paditësi nuk paraqet pretendimet e tij sipas nenit 26 kërkesa për arbitrazh konsiderohet e térheqrur.

Nëse i padituri nuk paraqet përgjigjen e tij sipas nenit 26, Trupi i Arbitrazhit procedon me arbitrimin dhe marrjen e vendimit.

Nëse njëra nga palët me gjithë njoftimin e marrë nuk paraqitet në seancën degjimore Trupi i Arbitrazhit mund të procedojë me zhvillimin e seances degjimore.

Neni 31
Vendimi

Vendimi i Trupi të Arbitrazhit merret me shumice të votave ose në mungesë të një shumice merret nga Drejtuesi i tij. Vendimi përmban datën dhe shkurtimisht arësyet e marrjes së tij me përjashtim kur palët bien dakort ndryshe. Vendimi nënshkruhet nga drejtuesi i Trupit të Arbitrazhit.

Vendimi i njofuar nga Sekretaria është i detyrueshëm për palët.

Neni 32
Ankimi

Vendimi i KAS mund të ankimohet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja dijeni, në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv në Luzanë, Zvicër, vendimi i së cilës është përfundimtar.

B. GJYKIMI NË SHKALLË TË DYTË

Neni 33
Rregulli i Përgjithshëm

Ankimi kundër vendimit të organizatave sportive mund të paraqitet në KAS kur statutet ose rregulloret e organizatave sportive parashikojën një gjë të tillë ose palët kanë arritur një marrëveshje të veçantë arbitrazhi dhe ankimuesi ka përdorur të gjitha mjetet ligjore në dispozicion të tij përpara paraqitjes së ankimit.

Neni 34
Kërkesa

Kërkesa duhet të bëhet me shkrim dhe të përbajë të dhënat e mëposhtme:

- emrin dhe adresen e plotë të palës paditëse dhe të palës së paditur;
- një kopje e vendimit që ankimohet;
- kërkesën e apeluesit për zgjidhje;
- caktimin e arbitrit nga apeluesi, përvec kur palët kanë rënë dakord për një trup arbitrazhi të përbërë nga 1(një) arbitër;
- nëse e zbatueshme kërkesën për ndalimin e zbatimit të vendimit te ankimuar së bashku me arësyet;
- kopje të dispozitave të statutit ose rregullores ose marrëveshjes së palëve që parashikon paraqitjen e apelimit përpara KAS;

Me depozitimin e kërkeses, pala kryen pagesën a tarifës sipas përcaktimeve të KOKSH.

Në rast se kërkesa e paraqitur nuk është e plotë sipas kërkesave të mësipërme, Sekretaria i cakton pales një afat 7 (shtatë) ditor për plotësimin e saj. Nëse Apeluesi nuk i plotëson ato brenda afatit të caktuar, kërkesa për apelim konsiderohet e tërhequr.

Neni 35
Afati për Paraqitjen e Kërkesës per Apelim

Në mungesë të afateve të përcaktuanë statutet ose rregulloret e organizatave sportive ose në marrëveshje, afati për paraqitjen e kërkesës së apelimit do të jetë 21(njëzet e një) ditë nga njoftimi i vendimit të ankimuar.

Kryetari i KAS, pas konsultimit me palët, mund të vendose të refuzojë marrjen në shqyrtim të kërkesës për apelim kur ajo është paraqitur shumë vonë.

Neni 36
Numri i Arbitrave

Apelimi do të paraqitet në një Trup Arbitrazhi të perbërë nga 3 (tre) arbitra përvèç kur ankuesi në momentin e paraqitjes së kërkesës për apelim deklaron se palët kanë rënë dakort për një Trup Arbitrazhi me 1 (një) arbitër ose, në mungesë të marrëveshjes mes palëve për numrin e arbitrave, Kryetari i KAS vendos paraqitjen e kërkesës për apelim tek një arbitër duke marrë parasysh rrethanat e çështjes.

Në rastet kur dy ose më shumë çështje kanë dukshëm të njëjtin objekt, Kryetari i KAS mund të ftojë palët të bien dakord që këto çështje t'i referohen të njëjtit Trup Aarbitrazhi; në mungesë të marrëveshjes së palëve vendos Kryetari KAS.

Neni 37
Përbledhja e Apelimit

Brenda 10 (dhjete) ditëve nga mbarimi i afatit për apelim, apeluesi do të paraqesë një përbledhje të shkurtër të faktave dhe argumentave ligjore për paraqitjen e kërkesës për apelim së bashku me provat materiale dhe provat e tjera mbi të cilat mbështet kërkesa e tij. Ne mungesë të paraqitjes së tyre kërkesa për apelim konsiderohet e tërhequr.

Ankimuesi në kërkesën e tij me shkrim do të përcaktojë dëshmitarët dhe ekspertët të që kërkon të thirren si dhe çdo masë tjeter. Deklarata e deshmitarit do të paraqitet së bashku me kërkesën më shkrim të apelimit, perveç ku Drejtuesi i Trupit të Arbitrazhit vendos ndryshe.

Neni 38

Fillimi i Arbitrazhit nga KAS

Perveç rastve kur që ne fillim është e dukshme se nuk ekziston asnjë marrëveshje arbitrazhi që i referohet KAS, në rastet e tjera KAS do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të venë në lëvizje gjykimin nëpërmjet arbitrazhit. Për këtë qëllim, në veçanti, Sekretaria e KAS do t'i komunikojë paditësit kërkesën për apelim dhe Kryetari i KAS do të procedoje me formimin e trupit të arbitrazhit në përputhje me nenet 39 dhe 40 të kësaj rregulloreje.

Me marrëveshje të palëve, Trupi i Arbitrazhit ose Kryetari i KAS në rastet kur Trupi i Arbitrazhit nuk ështe krijuar ende, mund të procedoje me procedure të përshpejtuar duke nxjerrë të gjitha udhëzimet e nevojshme për zhvillimin e kësaj procedure.

Neni 39

Caktimi i Arbitrit nga i Padituri

Përveç kur palët bien dakort për një trup arbitrazhi me 1(një) arbitër të vetëm ose Kryetari i KAS konsideron se apelimi është një rast urgjent dhe duhet të caktohet një arbitër i vetëm, i padituri do të caktojë një arbitër brenda 10 (dhjetë) ditëve pas njoftimit të kërkesës për apelim.

Në mungesë të caktimit të arbitrit brenda afatit të mësipërm, Kryetari i KAS do të procedojë me caktimin e arbitrit në vend të paditurit.

Neni 40

Caktimi i Arbitrit te Vetëm , Drejtuesit dhe Konfirmimi i Arbitrave

Nëse nga marrëveshja e palëve ose me vendim të Kryetarit te KAS do të caktohet 1(një) arbitër, Kryetari i KAS do të caktojë arbitrin me marrjen e kërkesës per apelim.

Nëse do të caktohen tre arbitra, Kryetari i KAS cakton Drejtues të Trupit të Arbitrazhit arbitrin e caktuar nga i padituri pas konsultimeve me arbitrat e tjerë. Arbitrat e zgjedhur nga palët konsiderohen të emeruar vetëm pasi konfirmohen si të tillë nga Kryetari i KAS.

Menjehere pas krijimit te Trupit te Arbitrazhit, Sekretaria i dergon dosjen e plotë të çështjes. Rregullat e përcaktuara në nenin 20 të kësaj rregulloreje do të zbatohen për analogji dhe për kërkesat për apelim të paraqitura nga disa apelues ose që i drejtohen disa të paditurve me përjashtim të zgjedhjes se Drejtuesit të Trupit te Arbitrazhit i cili zgjidhet nga Kryetari i KAS.

Neni 41 **Përgjigja e të Paditurit**

Brenda 20 (njëzet ditëve) nga marrja e arsyeve për apelim, i padituri do të paraqesë përgjigen e cila do të përmbajë:

- a) deklaratën mbrojtëse;
- b) mungesën e juridiksonit;
- c) çdo kundërkërkësë;
- d) çdo provë materiale ose saktësime për prova të tjera mbi të cilat i padituri do të mbështetet duke përfshirë emrin e dëshmitarëve dhe ekspertëve që mendon të thërrasë; deklaratat e dëshmitarëve, nesë ka, do të paraqiten së bashku me përgjigen, perveç se kur drejtuesi i trupit të arbitrazhit vendos ndryshe.

Nëse i padituri nuk paraqet përgjigen brenda afatit të caktuar, Trupi i Arbitrazhit mund të procedoje me arbitrazhin dhe te marrë një vendim.

Neni 42 **Apelimi dhe Përgjigja**

Palët nuk mund të plotësojne argumentat e tyre, të paraqesin prova të tjera materiale ose te specifikojnë më tej provat mbi të cilat do të mbështeten pasi janë paraqitur arsyet e apelimit dhe përgjigja ndaj tyre, përveç kur palët bien dakord ose Drejtuesi i Trupit të Arbitrazhit, në rrethana të jashtëzakonshme, urdhëron ndryshe.,

Neni 43

Rishikimi dhe Degjimi

Trupi i Arbitrazhit ka kompetence të plotë për rishikimin e fakteve dhe të ligjit. Ai mund te nxjerrë një vendim të ri i cili zvendëson vendimin e ankimuar ose anullon vendimin dhe e dergon çështjen për rishqyrtim në organin që e ka dhënë atë.

Drejtuesi i Trupit të Arbitrazhit pas marrjes së dosjes nxjerr udhëzime ne lidhje me seancën e dëgjimit të pretendimeve të palëve, deshmitarëve dhe ekspertëve si dhe të argumentave gojore. Ai gjithashtu mund të kërkojë dosjen e organizatës sportive vendimi i së cilës është ankimuar. Në këtë rast do të zbatohen rregullat e përcaktuara në nenet 27 dhe 28 të kësaj rregullorje.

Trup i Arbitrazhit, pas konsultimit me palët, mund të vendosë per mos zhvillimin e seancës dëgjore kur e konsideron se është shumë mirë i informuar për çështjen.

Nëse njëra nga palët nuk merr pjesë ne seancën dëgjimore megjithëse është njoftuar sipas rregullave, Trupi i Arbitrazhit procedon me zhivllimin e seances degjimore.

Neni 44

Vendimi

Vendimi merret me shumice votash ose në mungesë të një shumice merret nga Drejtuesi i Trupit të Arbitrazhit. Vendimi përban datën dhe shkurtimisht arësyet e marrjes së tij. Vendimi nënshkruhet nga Drejtuesi i Trupit të Arbitrazhit.

Trupi i Arbitrazhit mund t'u komunikojë palëve pjesën detyruesë të vendimit përpara arsyeve për marrjen e tij dhe vendimi to të jetë i detyrueshëm që nga momenti kur palëve i njoftohet me shkrim kjo pjesë e vendimit.

Vendim i njoftohet palëve nga Sekretaria dhe është i detyrueshëm për palët.

Pjesa detyruese e vendimit i njoftohet palëve brenda 4 (kater) muajve nga paraqitja e kërkesës për apelim. Ky afat mund të zgjatet nga Kryetari i KAS me kërkesë të Drejtuesit të Trupit të Arbitrazhit.

Vendimi, një përbledhje ose një konferencë shtypi lidhur me rezultatet e procedimit do të behen publike, perveç kur palët bien dakort që ky informacion duhet të mbetet konfidencial.

Neni 45

Ankimi

Vendimi mund të ankimohet brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga marrja dijeni, në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv në Luzanë, Zvicër, vendimi i së cilës është përfundimtar.

KREU IV
PROCEDURA PER DHENIE OPINIONI

Neni 46

Kërkesa per Dhenie Opinioni

Kërkesa per marrjen e opinionin te KAS depozitohet e shoqëruar nga çdo dokument i cili mendohet se mund t'i vijë në ndihmë Trupës së Arbitrazhit të ngarkuar me detyrën e dhënies së opinionit.

Neni 47

Shqyrtimi i Kërkesës

Me depozitimin e kërkesës për dhënie opinionin, Kryetari i KAS do te shqyrtojë nëse ka vend për dhënie opinionin në lidhje me kërkesën. Në rast se po, do te procedohet me krijimin e Trupës së Arbitrazhit prej një ose disa arbitrash nga lista e arbitrave dhe do te caktoje njërin prej tyre me cilësine e Kryetarit te trupës. Kryetari i KAS do te formulojë, sipas gjykimit të tij, pyetjet e paraqitura ne kërkesë dhe do ja kalojë per përgjigje (ne formën e opinionit) trupës se arbitrazhit të krijuar per këtë qellim.

Neni 48

Dhenia e Opinionit

Trupa e Arbitrazhit përpëra dhënies së opinionit mund te kérkoje informacione shtesë nga pala e interesuar. Opinion i dhënë mund te bëhet publik me pëlqimin e palës që ka bërë kërkesen, por nuk do të ketë karakter detyrues.

**KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 49

Për çdo gjë që nuk parashikohet në këtë rregullore do të zbatohen rregullat e përcaktuar në aktet që rregullojnë veprimtarinë tij sipas përcaktimeve në pjesën hyrëse të kësaj rregulloreje.

Çdo ndryshim i kësaj rregulloreje propozohet nga KAS dhe miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Komitetit Olimpik Shqiptar.